



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës- Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.7093/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit 03/L-048, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 04/L-079 neni 12, 14, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

**VENDIM  
PËR  
RI-ALOKIMIN E MJETEVE TË PROJEKTEVE KAPITALE**

**I**

Miratohet propozim vendimi me numër 04.Nr.7093 për ri-alokimin e mjeteve nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale.

**II**

Duke iu referuar nenit I miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës. Nga kjo kategori ekonomike kemi rialokimin e mjeteve financiare për projektet kapitale nga granti qeveritar (fondi 10) në shumën prej 8.497.00 €, nga të hyrat vetanake (fondi 21) në shumë prej 48.549.00 € dhe një transfer brenda programit nga granti qeveritar (fondi 10) në shumën prej 502.25 €, pra në total rialokimi i mjeteve financiare është në shumë prej 57.548.25 €.

**III**

Ri-alokimi i projekteve kapitale nga granti qeveritar (fondi 10).

Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) nga projektet:  
„Rikonstruimi i rrugës Ura e Fezës-rrafshe-Meliq” kod (86401) shuma prej 2,897.00 €,  
„Rënövimi dhe adoptimi i zyrave në objektin e komunës (ish qendra)” kod (86408) shuma prej 5,600.00 €, të alokohen në projektet :  
„Rregullimi i kanalizimit nga rruga e të përndjekurve - Ura e Fezës” kod (86404) në shumë prej 5,600.00 €, “Furnizim me kontinjer për Komunën e Hanit të Elezit” kod (84270) në shumë prej 1,298.00 € dhe „Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Laç” kod (86424) në shumë prej 1,599.00 €.

Rialokimi i projekteve kapitale nga të hyrat vetanake (fondi 21).

Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) nga projektet:  
„Rikonstruimi i rrugës Ura e Fezës-rrafshe-Meliq” kod (86401) shuma prej 15,000.00 €,

„Rregullimi i kanalizimit nga rruga e të përndjekurve - Ura e Fezës” kod (86404) në shumë prej 17.422.00 €;

„Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqëve – sh. f. Kështjella e Diturisë” kod (86405) shuma prej 2.055.20 €.

„Fonde për trajnime” kod (86421) shuma prej 2,000.00 €,

„Rregullimi i rrethojës së varrezave të dëshmorëve” kod (86426) shuma prej 6,598.80 € dhe

„Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës së Gorancës” kod (84269) shuma prej 5.473.00 € të rialokohen në projektet:

„Fonde për shpronësim” kod (86420) në shumë prej 2,640.00€,

„Rregullimi i kanalizimit përgjatë magjistrales (nga pompa e benzinës Unio Comerc deri te gropa septike)” kod (i ri) në shumë prej 35.000.00€,

„Mjete të lira për Bashkëinvestime” kod 86429 në shumë prej 6,409.00€ dhe

„Shtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit” me kod (86402) në shumë prej 4,500.00€

Transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale nga programi Arsim dhe Shkencë (920) nën-programi (95220) në programin Arsimit dhe shkencë (920) nën-programi (94020).

Nga programi Arsim dhe Shkencë (920) nën-programi (95220) nga projekti “Rregullimi i kulmit ndriçues të sh.m. Dardania” kod (86431) shuma prej 502.25€ të transferohet në programin Arsimit dhe shkencë (920) nën-programi (94020) në projektin “ Rregullimi i infrastrukturës shkollore” kod (86430) në shumë prej 502.25€.

#### IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

#### V

Me këtë vendim njoftohet : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit Komunal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:31.10.2012

